



2012

RAPORT VJETOR



Rr. Rrustem Statovci nr.29

Prishtinë, Kosovë

Tel:+381(0) 38 22 00 40

Fax:+381(0) 38 22 33 40

www.arh-ks.org

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	1
AKRONIMET.....	4
PARATHËNIE NGA BORDI MBIQYRËS.....	5
PARATHËNIE NGA KRYESHEFI EKZEKUTIV.....	7
HYRJE.....	9
ORGANOGRAMI I ARH-SË.....	10
DEPARTAMENTI LICENCIM/LIGJORË.....	11
LICENCIM.....	11
Aktivitetet e Departamentit të Licencimit.....	11
Procesi i Licencimit të INFRAKOS-it.....	12
Procesi i Licencimit të TRAINKOS-it.....	13
Njohja e Licensave Ndërkombetare.....	14
Regjistri i Licencimit.....	15
Përfundimi.....	15
Ligjorë.....	16
Detyrat dhe përgjegjësitë.....	16
Aktivitetet e Departamentit Ligjorë.....	17
DEPARTAMENTI I SIGURISË.....	18
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:.....	18
AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË SIGURISË.....	19
Procesi i konsultimeve për Autorizim të Sigurisë -2012,.....	20
Procesi i konsultimeve për Certifikatë të Sigurisë -2012.....	21
Njohja e Autorizimeve dhe Certifikatave Ndërkombetare.....	23
Regjistrimi i Infstrukturës hekurudhore.....	23
Aplikimi për Certifikatë të Sigurisë nga Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos.....	24
Aplikimi për Autorizim të Sigurisë nga Menaxheri i Infrastrukturës Infrakos.....	24
DEPARTAMENTI I INTEROPERABILITETIT.....	25
DEFINICIONI.....	25
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË.....	26
AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË INTEROPERABILITETIT.....	26
Regjistrimi i Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore.....	27
Procesi i Regjistrimit të Mjeteve Lëvizëse.....	28
Shënjëzimi i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës – VKM (Vehicle Keeper Marking).....	29
Krijimi i listës së plotë të STI-së, Specifikimeve Teknike për Interoperabilitet.....	30
Entitetet përgjegjëse për mirëmbajtje hekurudhore.....	31
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL.....	32
OBJEKTIVI I INTEROPERABILITETIT HEKURUDHORË.....	32

DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT Ë TREGUT	32
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT	33
AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË TREGUT	34
Shqyrtimi i Ankesës së Trainkos-it për Ekspozeun e Rrjetit 2013 nga Depaertamenti i Tregut	35
Procesi i Konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit 2013.....	36
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	38
AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS.....	38
DEPARTAMENTI I FINANCAVE	39
AKTIVITETE E DEPARTAMENTIT TË FINANCAVE	39
NDARJET BUXHETORE	42
PROJEKTI I MBËSHTETUR NGA ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN (ZBE).....	46
ËORKSHOOPI I ORGANIZUAR NGA TAIEX NË BASHKËPUNIM ME ARH-NË.....	46
ËORKSHOOP PËR LLOGARITJEN E KOSTOS DIREKTE.....	47
OBJEKTIVAT E ARH-S PËR VITIN 2013.....	48

AKRONIMET

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MF	Ministria e Financave
INFRAKOS	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
TRAINKOS	Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës
SH.A	Shoqëri Aksionare
AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
BE	Bashkimi Evropian
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
OB	Organizatrat Buxhetore
SEETO	South- East Europe Transport Observatory (Observatori i Transportit të Evropës Juglindore)
ERA	Agjensioni Evropian i Hekurudhave
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritetin Evropian
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
SMS	Safety Managment Sistem (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)
NVR	Nacional Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
VKM	Vehicle Keeper Marking (Shenjëzimi i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës)
ECM	Entity in Charge of Maintenance (Entiteti Përgjegjës për Mirëmbajtje)
CSM	Common Safety Method (Metodat e Përbashkëta të Sigurisë)
EC	European Comision (Komisioni Evropian)
ERADIS	European Railëay Agency Database of Interoperability and Safety (Baza e të dhënave e Agjensionit Evropian Hekurudhor për Interoperabilitet dhe Siguri)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet
CSI	Common Safety Indicator (Indikatorët e Përbashkët të Sigurisë)

PARATHËNIE NGA BORDI MBIQYRËS

Qëllimi i këtij dokumenti është të raportoj në bazë vjetore sipas ligjit në fuqi për progresin e bërë në ARH dhe informimin për ngjarjet kryesore për sektorin e hekurudhave për periudhën nga janar 2012 deri në dhjetor 2012.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është themeluar në bazë të ligjit Nr. 03/L-076 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është miratuar nga Kuvendi në qershor 2008. Ky ligj është aplikuar për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë. Si dhe ka përcaktuar themelimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave si bartës kryesor për zbatimin e këtij ligji. Po ashtu Ligji Nr. 03/L-076 rregullon licencimin, certifikimin, sigurinë, interoperabilitetin, hulumtimin e aksidenteve, rregullimin e tregut dhe lëshimin e lejeve që kanë të bëjnë me veprimtaritë hekurudhore në Kosovë.

Siç e dini vendi ynë është duke bere përpjekjet dhe hapat e nevojshëm në procesin e integritimit në BE. Integritim i cili bartë në vete mjaft komponentë që lidhen me transportin. Në këtë rast me transportin hekurudhor. Një ndër aktivitetet e rëndësishme për sektorin e transportit hekurudhor është edhe themelimi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Ky institucion është themeluar në vitin 2010, së pari me emërimin e anëtarëve të Bordit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pastaj, në të njëjtën kohë Bordi ka vazhduar në përcaktimin e strukturës organizative të funksionimit të institucionit dhe përzgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm.

Me punën e deritanishme ARH ka kaluar fazën e parë të themelimit dhe është afirmuar mirë brenda edhe jashtë vendit si institucion licencues, rregullator i tregut me kompetenca edhe për sigurinë në sektorin hekurudhor. Përveç organizimit të brendshëm ARH ka qenë menjëherë aktive në shumë aktivitete brenda dhe jashtë vendit. Me themelimin e ARH-së ka filluar edhe ristrukturimi i transportit hekurudhor në Kosovë, përkatësisht është realizuar edhe ndarja e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani, në Infrastrukturë (Infrakos) dhe Operim me Trena (Trainkos). ARH ka qenë anëtar aktiv në grupin punues për ndarjen e Hekurudhave të Kosovës.

ARH gjithashtu ka qenë aktive duke dhënë kontribut në grupet punuese gjatë hartimit të ligjit të ri për Hekurudhat në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-063 që tani është në fuqi. ARH gjatë vitit 2012 ka filluar edhe ristrukturimin e vet në bazë të ligjit të ri i cili ARH-në e definon si organ i pavarur rregullator i tregut dhe i sigurisë që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë, dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese. Po ashtu ARH është organizatë e pavarur buxhetore dhe për aktivitetin e vet i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës. Struktura e planifikuar tani është e kompletuar. Pra Bordi, Drejtori i Përgjithshëm, gjashtë Departamente dhe stafi tjetër teknik, gjithsejtë 17 të punësuar e bëjnë ARH-në institucion plotësisht funksional dhe efikas në kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj. Një fakt shqetësues për ne mbeten pagat jo konkurrenente me sektorin që ne mbulojmë.

ARH-ja është angazhuar në:

- Krijimin e një ekipi të fortë me stafin aktual të bazuar në ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale
- Bashkëpunim të mirë me institucione brenda dhe jashtë shtetit.

- Përgatitjen e të gjitha parakushteve të nevojshme ligjore për një tranzicion të qetë drejtë avancimit dhe sigurisë së transportit hekurudhor për të mirën globale të Kosovës.
- Politikën transparente të informacionit bazuar në qasjen dhe publikimin e të dhënave të rëndësishme nëpërmjet internetit www.arh-ks.org
- Lidhje të vazhdueshme me trupat rregullator dhe të sigurisë në transportin hekurudhor në region dhe më gjerë.
- Treg të hapur dhe konkurrues për investitorët në sektorin hekurudhor

Pra, pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Hekurudhave Nr. 04/L-063 janë bërë disa ndryshime në kuadër të ARH-s. Departamenti për Hetim të Incidenteve dhe Aksidenteve që ka qenë në kuadër të ARH-së tani ka kaluar KHAIA në kompetencë të Zyrës së Kryeministrit.

Tani bazuar në Ligjin aktual të Hekurudhave, ARH rregullon dhe mbikëqyrë këto fusha:

- Licencimin
- Sigurinë
- Rregullimin e Tregut Hekurudhor, dhe
- Interoperabilitetin

Në arritjen e këtyre sukseseve ARH ka pasur përkrahje të vazhdueshme nga Institucionet e Republikës së Kosovës dhe nga Bashkimi Evropian, konkretisht nga zyra ndërlidhëse e BE-së këtu në Prishtinë përmes financimit të projekteve për asistencë teknike.

ARH, fillimisht ka përfituar asistencë teknike nga Nëntori 2010 deri në Shkurt 2011 nga BCEOM-EGISI, projekt i cili ka qenë i financuar nga Bashkimi Evropian.

ARH, gjithashtu ka përfituar asistencë teknike edhe gjatë vitit 2012 deri në Shkurt 2013. Gjithashtu, edhe kjo asistencë teknike ka qenë e financuar nga Bashkimi Evropian. Konsulencë e cila ka dhënë kontribut të rëndësishëm në punën dhe zhvillimin e ARH-së, në katër fushat Kryesore; Licencimin, Sigurinë, Rregullimin e Tregut dhe Interoperabilitet.

Me miratimin e ligjit të ri dhe akteve tjera nënligjore ARH gjatë vitit 2012 ka bërë edhe licencimin e dy kompanive pas plotësimit të kushteve që kërkojnë.

Shumë shpejt ARH do të pajisë me Certifikatë të Sigurisë dhe Autorizim të Sigurisë Operatorin me Trena dhe Menaxherin e Infrastrukturës.

ARH tani do të vazhdoj të punoj intensivisht në përkrahje të reformave të gjithanshme në transportin hekurudhor, do të vazhdoj me monitorimin e kompanive dhe përmes informimit, këshillëdhënjes dhe mekanizmave ligjor të ngritë nivelin e sigurisë dhe të promovoj tregun e hapur dhe konkurrent në transportin hekurudhor.

Ky akt ka hapur rrugën për lindjen e ndërmarrjeve të reja hekurudhore në Kosovë, kompanive private dhe / ose publike, ndërsa që të gjithë do të mund ta përdorin infrastrukturën e cila do vazhdoj të jetë në pronësi publike.

PARATHËNIE NGA KRYESHEFI EKZEKUTIV

Ky është raporti i tretë me radhë, si një rregullator i pavarur. ARH-ja është e ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe i cili vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH-ja ofron shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Raporti ofron dhe siguron informacione përmbajtjesore mbi progresin e angazhimeve dhe punëve të ARH-së në arritjen e objektivave dhe qëllimeve strategjike të saj, disa prej të cilave do të vazhdojnë përtej vitit 2012.

Raporti gjithashtu përmbledh dhe paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme për aktivitetet e rreguluara në sektorin e transportit Hekurudhor në Republikën e Kosovës.

ARH brenda mandatit të saj ka nxjerrë akte nënligjore, rregullore dhe udhëzime administrative për implementimin e ligjit, gjatë vitit 2012 ka vazhduar ta kompletë legjislacionin, përmes hartimit dhe miratimit të rregulloreve dhe akteve nënligjore të reja me qëllim të bashkërenditjes së aktiviteteve që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe politikave në sektorin e transportit hekurudhor.

Një ndër aktivitetet më të rëndësishme të ARH-së ka qenë organizimi i Punëtorisë në lidhje me pasojat e ndryshimeve më të rëndësishme në Direktivë për krijimin e një Zone të Vetme Evropiane Hekurudhore për Zonën Perindimore të Ballkanit të mbështetur nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, ku si implementues i projektit ka qenë TAIEK. Si dhe Organizimi i punëtorisë lidhur me shpenzimet e kostos direkte i përkrahur po ashtu nga TAIEK.

Licencimi i dy kompanive hekurudhore, Kompania për Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS Sh.A dhe Kompania për Operimet me Trena të Hekurudhave të Kosovës TRAINKOS Sh.A.

Procesi i konsultimeve për Ekspozitën e Rrjetit 2013, promovimin dhe mbështetjen e plotë të konkurrencës së drejtë në përputhje me dispozitat në fuqi, rregullimin dhe aplikimin e standardeve unike për të gjithë ofruesit e shërbimeve të transportit Hekurudhor, zhvillimin e politikave jo diskriminuese ndaj të gjithë atyre që dëshirojnë të hyjnë në këtë treg, si dhe mbrojtjen maksimale të mundshme të konsumatorëve që përdorin shërbimet e ofruara të transportit Hekurudhor.

Aplikimi i dy kompanive për Autorizim dhe Certifikata të Sigurisë dhe Regjistrimi i mjeteve Lëvizëse.

Kam kënaqësinë të raportoj se në të gjitha këto zhvillime ARH-ja ka pasur rol të rëndësishëm përmes shqyrtimit dhe miratimit të rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, duke bërë konsultime publike, me të gjitha palët e interesit.

Gjatë vitit 2012, ARH-ja ka bërë përpjekje maksimale me qëllim të definimit praktik të pozitës së tij në raport me institucionet tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kjo ka të bëjë veçanërisht me pozitën e saj si institucion rregullator i pavarur, ku kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë janë të definuara sipas Ligjit të Hekurudhave të Kosovës.

ARH gjatë vitit 2012 ka pranuar asistencë teknike shumë të vlefshme dhe domethënëse nga Komisioni Evropian duke realizuar përkrahje me ekspert të sektorit hekurudhor të ardhur nga institucionet homologe të shteteve të BE-së (Mobility Consultants), të cilët kanë dhënë një kontribut dhe përkrahje shumë të çmuar për suksesin në punë të ARH-së.

ARH-ja punën e vet e mbështet në bashkëpunimin e mirë e të besueshëm me të gjitha palët e interesuara në sektorin e transportit hekurudhor si: INFRAKOS, TRAINKOS, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.

ARH-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi AAC për shkëmbimin e përvojave në mes dy Institucioneve.

ARH mbetet e përkushtuar për ta mbrojtur mirëqenien ekonomike të konsumatorëve të transportit në Kosovë duke siguruar transport hekurudhor, konkurrues dhe efikas.

ARH-ja ka pasur një buxhet jo të kënaqshëm i cili ka pamundësuar përmbushjen e plotësisht të stafit dhe shërbimeve tjera buxhetore, andaj besoj që kjo vështirësi është adresuar me kohë të të gjitha institucionet përkatëse, ku pastaj kemi pranuar përkrahje në rishikimin e buxhetit të vitit 2012, me aprovimin e pesë pozitave dhe ngritje në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe kemi rritje të buxhetit për vitin 2013. Kjo përkrahje ka ardhur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa me rekomandimin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të Kuvendit të Republikës së Kosovës në mënyrë që ARH-ja të ketë mundësi që të funksionon sa më mirë..

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë stafin për përpjekjet dhe zotimin e tyre të palëkundur për kryerjen me sukses të përgjegjësiave dhe obligimeve të tyre të mëdha.

HYRJE


Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave funksionon në bazë të ligjit nr. 04/L-063

ARH -ja është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave rregullon dhe mbikëqyr këto fusha:

- *Licensimin*
- *Sigurinë*
- *Interoperabilitetin*
- *Rregullimin e Tregut*

ORGANOGRAMI I ARH-së



DEPARTAMENTI LICENCIM/LIGJORË

▪ Licencim

Departamenti i Licencimit është themeluar në Prill të vitit 2011.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-063 me datë 01.01.2012, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për :

Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
Licencimin e Makinistëve, dhe
Amandamentimin, Suspendimin, dhe Revokimin e Licencave të lëshuara.

Aktivitetet e Departamentit të Licencimit

Që nga data 15. 11. 2012 TRAINKOS dhe INFRAKOS janë licencuar nga ARH-ja

Gjatë vitit 2012 Departamenti i Licencimit ka pasur dy objektiva kryesore. E para, ka qenë kompletimi i bazës ligjore sekondare, dhe licencimi i Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore INFRAKOS, gjithashtu licencimin e Operimit me Trena TRAINKOS.

Departamenti i Licencimit si njëri nga detyrat primare pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Hekurudhave, ka përcaktuar kompletimin e akteve nënligjore të kërkuara nga Ligji i Hekurudhave për fillimin e procesit të licencimit për TRAINKOS-in dhe INFRAKOS-in. Departamenti i Licencimit, së bashku me palët e interesit në këtë proces, përfshirë edhe Ministrinë e Infrastrukturës kanë filluar përgatitjen e dy draft Udhëzimeve Administrative për Licencim.

Si rezultat i punës së të gjitha palëve të përfshira në hartimin e këtyre akteve nënligjore, janë nxjerr:

Udhëzimi Administrativ Nr. 02/ 2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore me datë 07. 05. 2012

Udhëzimi Administrativ Nr. 03. 2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës me datë 06. 07. 2012.

Departamenti i Licencimit ka përgatitur draftin e parë të Rregullores Nr. 01/ 2012 për Licencim dhe me datë 22. 06. 2012 është miratuar nga Bordi i ARH-së.

Dhe në këtë mënyrë është kompletuar baza ligjore sekondare për licencimin e Menaxherit të Infrastrukturës INFRAKOS dhe Ndërmarrjen Hekurudhore TRAINKOS. Departamenti i Licencimit pas kompletimit të bazës ligjore sekondare për licencim me datë 26. 06. 2012 ka dërguar shkresa zyrtare tek TRAINKOS dhe INFRAKOS për të njoftuar fillimin e procesit të licencimit.

Procesi i Licencimit është organizuar në formë zyrtare e cila ka konsistuar në njoftimet zyrtare përmes shkresave të ndryshme që ARH ka adresuar tek TRAINKOS dhe INFRAKOS, si dhe takimet e rregullta gjatë fazës përgatitore të Udhëzimeve Administrative dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë që ti njoftojmë palët e përfshira TRAINKOS dhe INFRAKOS rreth procedurave të ardhshme.

Procesi paralel i konsultimeve të Departamentit të Licencimit me kompanitë ka qenë shumë frytdhënës, për arsye se të gjitha palët e përfshira në proces janë informuar se si të implementojnë kërkesat ligjore gjatë procesit të licencimit.

Procesi i Licencimit të INFRAKOS-it

Pas pranimit të aplikacionit të INFRAKOS-it për Licencim, Departamenti përgjegjës ka dërguar shkresë zyrtare me datë 18. 07. 2012 tek INFRAKOS-i. Përmes kësaj shkrese, Departamenti i Licencimit ka konfirmuar pranimin e aplikacionit (edhe pse jo të kompletuar) dhe ka ngritur shqetësimet e radhës:

- Forma e Aplikacionit e përdorur nga INFRAKOS nuk ka qenë forma zyrtare e ARH-së.
- Kemi kërkuar informacion shtesë bazuar në dispozitat ligjore në fuqi lidhur me Përshtatshmërinë Financiare bazuar në Ligjin e Hekurudhave është njëra nga kriteret bazë për Licencim, neni 46. 2.5.
- Gjithashtu është kërkuar informacion shtesë rreth Sigurimit të kompanisë, pasi që edhe ky ka qenë kusht ligjor për licencim.

Aplikacioni i INFRAKOS-it për Licencë është pranuar në Departamentin e Licencimit me datë **16. 07. 2012**

Si rezultat i kësaj shkrese zyrtare, INFRAKOS me datë 19. 07.2012 ka kompletuar aplikacionin fillestar, ku ka përdorur formën zyrtare të aplikacionit siç kërkohet nga Rregullorja e Licencimit. Gjithashtu na kanë njoftuar se janë në proces të tenderimit për Sigurimin e INFRAKOS-it.

Departamenti i Licencimit me datë 29. 08. 2012 ka dërguar edhe një shkresë zyrtare tek INFRAKOS-i, ku i ka kërkuar të na njoftoj me gjendjen apo procedurat e Sigurimit të kompanisë. Për arsye se pa plotësimin e këtij kushti, Departamenti i Licencimit nuk ka mundur të marr vendim për licencim. Si rezultat, me datë 05. 10. 2012 INFRAKOS ka sjell në ARH kontratën e nënshkruar të Sigurimit ku mbulohen edhe palët e treta dhe në këtë mënyrë Departamenti i Licencimit konstaton se i gjithë dokumentacioni relevantë është dorëzuar, dhe se aplikacioni mund të shqyrtohet dhe merret vendimi.

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave nenin 23 paragrafi 3, Departamenti i Licencimit duhet të marrë vendim në lidhje me aplikacionin sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tre (3) muaj pasi të jetë dorëzuar i gjithë informacioni relevant.

Në mbështetje të dispozitave ligjore dhe brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Ligji i Hekurudhave, Departamenti i Licencimit pas vlerësimit me kujdes të materialit relevant merr Vendimi pozitiv për licencimin e INFRAKOS-it, me datë 15. 11. 2012.

Numri i Licencës së INFRAKOS-i është: KS 02/ 2012 0001, është në harmoni të plotë me sistemin e numërimit të Licencave sipas Vendimit të Bashkimit Evropian Nr. 2011/107EU, Aneksi 2, 'Struktura dhe Përmbajtja e Numrave Evropian të Identifikimit'

Departamenti i Licencimit në Vendimin e datës 15. 11. 2012 ka lëshuar këto lloje të Licencave për INFRAKOS-in:

- *Licencë për menaxhimin e rrjetit hekurudhor dhe infrastrukturës hekurudhore*
- *Licence për mirëmbajtjen e depove për mjetet lëvizëse hekurudhore dhe mjeteve tjera të mirëmbajtjes*
- *Licencë për stacione dhe stacione për formim dhe shformim të trenave, stacione (ranzhiruese)*
- *Licencë për operate të kombinuara të rrjetit hekurudhor dhe infrastrukturës hekurudhore, dhe stacioneve ranzhiruese.*

Procesi i Licencimit të TRAINKOS-it

Pas pranimit të aplikacionit të TRAINKOS-it për Licencim, Departamenti përgjegjës ka dërguar shkresë zyrtare me datë 17. 09. 2012 tek TRAINKOS. Përmes kësaj shkrese ARH ka konfirmuar pranimin e aplikacionit për Licencim dhe ka siguruar zyrtarët përgjegjës të TRAINKOS-it, se materiali i aplikacionit do të shqyrtohet sa më parë që është e mundur, konform dispozitave ligjore në fuqi.

Departamenti i Licencimit, pas pranimit të gjithë dokumentacionit relevant të TRAINKOS-it për Licencim, ka shqyrtuar atë me kujdes në të gjitha pikat e kërkuara nga legjislacioni pozitiv siç janë: Reputacioni i mirë, Përshtatshmëria Financiare, Profesionalizmi, dhe Sigurimi i kompanisë përfshirë palët e treta dhe si rezultat ka ardhur në vlerësimin pozitiv.

TRAINKOS, gjithashtu ka aplikuar edhe për: 1) Licencë për mirëmbajtjen e depove për mjetet lëvizëse hekurudhore dhe mjeteve tjera të mirëmbajtjes dhe 2) Licencë për operime të kombinuara të rrjetit hekurudhor dhe infrastrukturës hekurudhore dhe stacioneve ranzhiruese. Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxhereve të Infrastrukturës, neni 3 këto lloje të licencave janë për Menaxher të Infrastrukturës. Në këtë rast Departamenti i Licencimit konstaton se: TRAINKOS nuk është Menaxher i Infrastrukturës dhe për këtë arsye nuk mund ti marre këto lloje të licencave. Sidoqoftë, refuzimi i këtyre licencave në asnjë mënyrë nuk e kufizon veprimtarinë aktuale të operimit të TRAINKOSIT. Ky përfundim është cekur edhe në Vendimin e Licencimit, përkatësisht refuzimit të këtyre dy lloje të licencave.

Aplikacioni i TRAINKOS-it për Licencë është pranuar në Departamentin e Licencimit me datë **14.09. 2012**

Më datë **15.11.2012** Departamenti i Licencimit merr Vendim për Licencimin e TRAINKOS-it .

Departamenti i Licencimit, në Vendimin e datës 15. 11. 2012 ka lëshuar këto lloje të Licencave për TRAINKOS-in:

- Licencë për udhëtar*
- Licencë për mallra, dhe*
- Licencë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore.*

Njohja e Licencave Ndërkombëtare

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 03/ 2012, ARH mund të pajtohet për njohjen e Licencave të lëshuara në vendet e Bashkimit Evropian dhe vende tjera, nëse ato Licenca janë në pajtueshmëri me legjislacionin e Kosovës në fuqi. Gjithashtu, ARH ka bërë një hap tjetër në liberalizimin e tregut hekurudhor, përveç njohjeve dhe ky hap është shumë me rëndësi, sepse aplikimi për marrjen e një Licence apo aplikimi për njohje të Licencës është pa pagesë për 5 vitet e ardhshme. Këto dy fakte janë vlerësuar tejet pozitivisht nga zyrtarët e Bashkimit Evropian.

Regjistri i Licencimit

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave, neni 10 paragrafi 3 , si dhe Rregulloren e miratuar nga Bordi nr.01/2012, ARH-ja duhet të siguroj mbajtjen dhe freskimin e regjistrit të licencave. Departamenti i Licencimit, pas marrje së Vendimit për licencimin e INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it, në mënyrë që të përmbushë edhe këtë kërkesë ligjore ka zhvilluar regjistrin e Licencimit dhe ka publikuar atë në ueb faqen e ARH-së, konform standardeve dhe praktikave të përdorura nga Agjencia Evropiane e Hekurudhave.

Nr.	Emri dhe adresa e kompanive	Nr. i Licencës	Data e dhënies së Licencës	Llojet e shërbimeve	Territori	Afati i Licencës nga	Vërejtje
1	TRAINKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë	KS 01/2012 0001	15.11.2012	Operimi me Trena	RKS	15.11.2012	
2	INFRAKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë	KS 02/2012 0001	15.11.2012	Menaxher i Infrastrukturës	RKS	15.11.2012	

Përfundimi

Si rezultat, Departamenti i Licencimit gjatë vitit 2012 ka arritur që suksesshëm, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese ta përmbyllë procesin e draftimit të kërkesave ligjore sekondare ose akteve tjera që kërkojnë me bazën ligjore sekondare dhe Licencimin. Që nga data **15. 11. 2012** Menaxheri i Infrastrukturës INFRAKOS- dhe Ndërmarrja Hekurudhore TRAINKOS, janë licencuar. Në këtë mënyrë është zbatuar Ligji i Hekurudhave së bashku me aktet tjera nënligjore, dhe gjithashtu është përmbushur një kërkesë themelore në rregullimin e tregut hekurudhore e ngritur disa herë edhe në raportet e progresit të Bashkimit Evropian.

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave, të gjitha Licencat e lëshuara janë pa afat të caktuar, porse ato duhet të rishikohen në baza të rregullta, së paku një herë në pesë (5) vite nga organi i cili i ka lëshuar ato. Departamenti i Licencimit, do të bëjë rishikimin e Licencave të lëshuara në baza të rregullta konform dispozitave ligjore në fuqi

▪ Ligjorë

Departamenti Ligjor është themeluar në Prill të vitit 2011.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Mbështetja e të gjitha departamenteve të ARH-së në çështjet ligjore, verifikimi i dokumenteve ligjore të lëshuara nga ARH-ja, pjesëmarrja në grupe të ndryshme punuese për hartim të legjislacionit primar dhe sekondar në sektorin e transportit hekurudhor, hartimi i akteve nënligjore në kuadër të ARH-së duke marrë parasysh legjislacionin e BE-së në fushën përkatëse, atëherë kur është e nevojshme dhe e mundur, etj.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Hekurudhave me 01. 01. 2012, Departamenti Ligjorë ka përcaktuar mes tjerash para vetes dy detyra kryesore. Fillimisht, zbatimi i dispozitave të reja ligjore të parapara në këtë ligj dhe se dyti, kompletimi i infrastrukturës nënligjore për të gjitha Departamentet në kuadër të ARH-s. Kompletimi i infrastrukturës ligjore sekondare ka qenë e orientuar në nxjerrjen e Udhëzimeve Administrative në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, duke u mbështetur në

Nenin 8 paragrafi 2. Dhe orientimi i dytë, ka qenë përgatitja e draft Rregulloreve në kuadër të fushëveprimit të ARH-s, duke u mbështetur në Nenin 38 paragrafin 2 në bashkëpunim të ngushtë edhe me konsulentët ndërkombëtar të angazhuar në ARH dhe të financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Aktivitetet e Departamentit Ligjorë

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2012 ka kontribuar në përgatitjen dhe nxjerrjen e akteve nënligjore të mëposhtme:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore
- Rregulloren Nr. 02. 2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatë të Sigurisë
- Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë
- Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore, dhe
- Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës

Po ashtu, Departamenti Ligjor gjatë vitit 2012 ka qenë intensivisht i përfshirë në 'Pyetësin për Studimin e Fizibilitetit' të Bashkimit Evropian në çështjet e ndërlidhura me transportin hekurudhore, të cilat janë në fushëveprimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Një kontribut po aq i rëndësishëm i Departamentit Ligjor gjatë vitit 2012 ka qenë, interpretimi i dispozitave të caktuara të Ligjit të Hekurudhave, për arsye se versioni i Ligjit në gjuhën Shqipe dhe atë Angleze, kanë kontradikta të shumta në pjesë të ndryshme të Ligjit.

Gjatë vitit 2012 Departamenti Ligjor ka ofruar interpretim ligjor për çdo akt juridik që është lëshuar nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, atëherë kur një gjë e tillë i është kërkuar. Përveç akteve nënligjore, që në të gjitha rastet janë adresuar tek Departamenti Ligjor për verifikim dhe kontribut, Departamentet tjera në kuadër të ARH-së kanë kërkuar mendimet dhe kontributin e Departamentit Ligjor edhe në raste tjera. p.sh. Departamenti Ligjor ka qenë direkt i përfshirë në Ankesën e TRAINKOS-it kundër INFRAKOS-it të datës 31. 05. 2012. Po ashtu, edhe Departamenti i Sigurisë me rastin e marrjes së Vendimit për dhënien e Autorizimit dhe Certifikatën e Sigurisë, ka kërkuar opinion ligjor. Një praktikë e ngjashme ka ekzistuar edhe në raste të tjera, ku Departamenti Ligjor ka inkurajuar gjitha Departamentet tjera që të gjitha çështjet ligjore t'i adresojnë tek Departamenti Ligjorë.

Në të njëjtën kohë, Departamenti Ligjor në bashkëpunim të ngushtë edhe me ekspertët ndërkombëtar të angazhuar në ARH dhe të financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian, kanë hartuar një listë të detajizuar se cilat akte nënligjore duhet të nxirren gjatë vitit 2013, dhe nga kush duhet të nxirren. Kjo listë e akteve nënligjore do të jetë udhërrëfyes i punës së Departamentit Ligjor gjatë vitit 2013. Në mënyrë që Ligji i hekurudhave të gjejë zbatueshmëri të plotë dhe që sektori hekurudhor të rregullohet dhe mbikëqyret nga ARH-ja në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese, sipas praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

DEPARTAMENTI I SIGURISË

Departamenti i Sigurisë është themeluar në Prill të vitit 2012.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-063 me datë 01.01.2012, Departamenti i Sigurisë është përgjegjës për :

- Autorizimin për futjen në shërbim të nën sistemeve strukturale,
- Mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për Interoperabilitet,
- Autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse,
- Regjistrimin e Infrastrukturës,
- Lëshimin, përtëritjen, amendamentimin dhe revokimin e Certifikatave të Sigurisë dhe Autorizimeve të Sigurisë.

Bazuar në ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 neni 20, Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore respektivisht Departamenti i Sigurisë në kuadër të ARH-së, përpilon një raport vjetor në lidhje me sigurinë, ku përshkruhen të arriturat kryesore gjatë vitit paraprak.

Departamenti i Sigurisë ka filluar të kompletohet me stafin profesional nga fillimi i muajit mars 2012, ku fillimisht ka filluar punën Inspektori i Sigurisë, pastaj nga fillimi i muajit prill 2012 Departamenti i Sigurisë është plotësuar edhe me pozitën e Kryesuesit të Departamentit të Sigurisë, kurse nga muaji tetor kemi edhe një Asistent të Sigurisë, kjo është koha prej kur kemi filluar të funksionojmë si departament i kompletuar.

Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë

Me datë 25.09.2012 është përfunduar Regjistrimi i Infrastrukturës hekurudhore

Me datë 26.11.2012 kemi pranuar aplikacionin për Certifikatë të Sigurisë nga Trainkos-i

Me datë 12.12.2012 kemi pranuar aplikacionin për Autorizim të Sigurisë nga Infrakos-i

Gjatë vitit 2012 Departamenti i Sigurisë ka pasur si objektiva kryesore kompletimin e bazës ligjore sekondar dhe krijimin e kushteve për fillimin e procesit të dhënies së Autorizimit të Sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos, dhe Certifikatës së Sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore Trainkos. Departamenti i Sigurisë, së bashku me palët e interesit në këtë proces, përfshirë edhe Ministrinë e Infrastrukturës kemi filluar përgatitjen e draft Udhëzimit Administrativ për dhënien e Autorizimit dhe Certifikatës së Sigurisë dhe përgatitjen e rregulloreve tjera të nevojshme.

Si rezultat i punës së përbashkët të të gjitha palëve të përfshira në hartimin e këtyre akteve nënligjore, me datë 06. 08. 2012 është nxjerrë :

Udhëzimi Administrativ Nr. 04/ 2012 për dhënien e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimin e Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës

Departamenti i Sigurisë ka përgatitur draft Rregulloret siç janë:

- *Rregullore Nr. 02/ 2012 për Certifikatë të Sigurisë me datë 23. 08. 2012.*
- *Rregullore Nr. 03/ 2012 për Autorizim të Sigurisë me datë 23. 08. 2012.*
- *Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës me datë 19. 10. 2012.*

Me fillimin e punës kryesisht jemi fokusuar në analizimin e Ligjit 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, me fokus të veçantë në Rregulloret për Sigurinë të nxjerra nga Bordi i ARH-së, pastaj kemi filluar të përgatisim një strategji se në cilat fusha do të fokusohemi më tepër për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë në sektorin hekurudhor siç janë:

- *Ligji 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,*
- *Rregullat mbi vërtetimet e Sigurisë Hekurudhore për kandidatët për operator hekurudhor,*
- *Rregullim të komunikacionit në linjat hekurudhore të pajisura me telekomandim (CTC),*
- *Transportin e materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor dhe hekurudhor,*
- *Strategjia e Transportit Multimodal dhe azhurnimi Planti të Veprimit 2012-2016,*

Procesi i konsultimeve për Autorizim të Sigurisë -2012,

Departamenti i Sigurisë përpos përgatitjes së infrastrukturës ligjore për dhënien e Autorizimit të Sigurisë, përgatitjen e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/ 2012 për dhënien e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimin e Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës. Rregulloren Nr. 03/ 2012 për Autorizim të Sigurisë, ne kemi zhvilluar një aktivitet të gjerë të konsultimit me Menaxherin e Infrastrukturës dhe palët e tjera të interesit, duke mbajtur takime të shumta dhe intensive në baza ditore, javore dhe mujore, për të informuar mbi rëndësinë e përgatitjes së kompanisë Infrakos për plotësimin e të gjitha detyrimeve ligjore të parapara me ligjin për Hekurudhat e Kosovës dhe me direktivat e BE-së.

Një kontribut të madh në këtë proces ka dhënë konsulenca ndërkombëtare, si dhe Ligji për Hekurudhat dhe Rregulloret e nxjerra nga Bordi i ARH-se në sqarimin e obligimeve dhe detyrave të cilat Infrakos duhet të plotësoj deri në aplikimin për Autorizim të Sigurisë siç janë:

- Projektimi dhe Implementimi i SMS-së (Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë) për kompaninë Infrakos,
- Përgatitjen e formularëve standard dhe udhëzimit për aplikim të Autorizimit të Sigurisë,
- Si të aplikohet për Autorizim të Sigurisë-procedurat dhe dokumentet,
- Përgatitjen e Deklaratave të Përputhshmërisë (Konformitetit) për Infrakos,
- Përgatitjen e Deklaratave të Përputhshmërisë (Konformitetit) për Infrakos,

Procesi i konsultimeve për Certifikatë të Sigurisë -2012

Departamenti i Sigurisë krahas përgatitjes së infrastrukturës ligjore për dhënien e Certifikatës së Sigurisë, përgatitjen e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/ 2012 për dhënien e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimin e Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës. Rregulloren Nr. 02/ 2012 për Certifikatë të Sigurisë, ne kemi zhvilluar një aktivitet të gjerë të konsultimit me Ndërmarrjen Hekurudhore dhe palët tjera të interesit, duke mbajtur takime të shumta dhe intensive për të informuar mbi rëndësinë e përgatitjes së kompanisë Trainkos për plotësimin e të gjitha detyrimeve ligjore të parapara me ligjin për Hekurudhat e Kosovës dhe me Direktivat e BE-së.

Në këtë proces kemi bërë sqarimin e obligimeve dhe detyrave të cilat Trainkos duhet ti plotësoj deri në aplikimin për Certifikatë të Sigurisë siç janë:

- Projektimi dhe Implementimi i SMS-së (Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë) për kompaninë Trainkos,
- Përgatitjen e formularëve standard dhe udhëzimit për aplikim për Certifikatë të Sigurisë,
- Si të aplikohet për Certifikatë të Sigurisë-procedurat dhe dokumentet,
- Përgatitjen e Deklaratave të Përputhshmërisë (Konformitetit) për Trainkos.

Të gjithë formularët e aplikimit, deklaratat e përputhshmërisë, formularët standard të Autorizimit dhe Certifikatës së sigurisë, janë plotësisht të harmonizuara me ato të cilat përdoren në vendet anëtare të ERA-s.

Gjithashtu gjatë kësaj kohe një ndihmë të madhe në realizimin e synimeve tona si Departament i Sigurisë kanë dhënë edhe materialet e shumta të cilat i kemi shfrytëzuar nga Agjencioni Evropian i Hekurudhave ERA, ku pas konsultimeve me konsulencën ndërkombëtare se a duhet të përdoren këto të dhëna, kemi marrë përgjigje se jo vetëm që duhet të përdoren por janë obligative për tu përdorur, përderisa ligji ynë për hekurudha është i harmonizuar me Direktivat e Agjencionit Evropian të Hekurudhave ERA. Kryesisht kemi analizuar materiale të publikuara në ueb-faqe të ERA-së të cilat kanë qenë të një rëndësie të veçantë për ne pasi që ne shumë më lehtë dhe me shpejt kemi mundur që të sigurojmë material shumë të rëndësishëm nga fusha e sigurisë hekurudhore.

Materialet që më së shumti i kemi përdorur nga ERA janë:

- *Directive 2004/49/EC,*
- *ERA-(Safety unit) Implementation Guidance for CSI,*
- *Safety in railway tunnels (Directive 2001/16/EC&Directive 96/48/EC),*
- *User Manual - ERADIS Safety Documents,*
- *EU IPA program*
- *Introducing the concepts of a safety management system and the common safety method for conformity assessment,*
- *Accreditation & Recognition scheme ëithin Regulation on the CSM on Risk Assessment,*
- *Safety Management System, Assessment Criteria for Railway Undertakings and Infrastructure Managers,*
- *European Railway Agency, Impact Assessment Report – CSM on Risk Assessment,*
- *Application guide for the design and implementation of a Railway Safety Management System,*
- *European Railway Agency core objective and role*
- *Common safety method for assessing conformity ëith the requirements for obtaining railway safety certificates*
- *Directive 2004/49/EC- (Commission Regulation (EC) no 653/2007)*
- *Safety Authorisation and Safety Certificates, application documents in accordance ëith article 10 of Directive 2004/49/ec of the European Parliament and of the Council and on the validity of Safety Authorisation and Safety Certificates delivered under Directive 2001/14/EC*

Njohja e Autorizimeve dhe Certifikatave Ndërkombëtare

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave, Udhëzimin Administrativ Nr. 04/ 2012 për dhënien e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimit të Sigurisë nxjerrë nga MI për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës, ARH mund të pajtohet për njohjen e Autorizimeve dhe Certifikatave të Sigurisë pjesa A, të lëshuara në vendet e Bashkimit Evropian dhe vende tjera, nëse ato janë në pajtueshmëri me legjislacionin e Kosovës në fuqi. Gjithashtu, ARH ka bërë një hap tjetër në liberalizimin e tregut hekurudhor, ku përveç njohjeve kemi vendosur që aplikimi për marrjen e një Certifikate të Sigurisë dhe Autorizimit të Sigurisë është pa pagesë për 5 vitet e ardhshme. Këto fakte janë vlerësuar tejet pozitivisht nga zyrtarët e Bashkimit Evropian.

Regjistrimi i Infrastrukturës hekurudhore

Departamenti i Sigurisë pas përgatitjes së infrastrukturës ligjore për Regjistrimin e Infrastrukturës Hekurudhore, përgatitjen e Rregullores Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e

Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës është përfunduar me datë 19. 10. 2012.

Infrastrukturës, kemi zhvilluar një aktivitet të gjerë të konsultimit me Menaxherin e Infrastrukturës dhe palët tjera të interesit, duke mbajtur takime të shumta dhe intensive për të informuar mbi rëndësinë e Regjistrimit të Infrastrukturës dhe përgatitjen e kompanisë Infrakos për plotësimin e të gjitha detyrimeve ligjore të parapara me ligjin për hekurudhat e Kosovës dhe me direktivat e BE-së.

Me datë 25.09.2012, është kryer Regjistrimi i Infrastrukturës hekurudhore

Pas pranimit të Regjistrimit të Infrastrukturës kemi filluar me procesin e vlerësimit të këtij regjistrimi dhe pas plotësimeve të nevojshme të cilat i kemi bërë së bashku me Menaxherin e Infrastrukturës Infrakos, kemi ardhur në përfundim se ky regjistrim është bërë konform kërkesave të parashtruara nga ana e ARH-së gjegjësisht Departamentit të Sigurisë, kështu me datë 25.09.2012 kemi vlerësuar dhe pranuar këtë regjistrim të Infrastrukturës si të rregullt dhe të plotë.

Aplikimi për Certifikatë të Sigurisë nga Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos

Pas përmbylljes me sukses të gjithë procesit të konsultimeve, përgatitjes së formularëve standard për aplikim sipas versionit të përdorur në ERA, përgatitjes së formularit të Certifikatës së Sigurisë në gjuhën shqipe ne me datën 26.11.2012 kemi pranuar Aplikimin për Certifikatë të Sigurisë nga Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos, me çka edhe e kemi filluar procesin e vlerësimit të këtij aplikacioni, ku presim që deri ka fundi i muajit Janar 2013 ta përfundojmë këtë proces me sukses dhe kompanisë hekurudhore Trainkos ti jepet Certifikata e Sigurisë pjesa A dhe B.

Me datë 26.11.2012, kemi pranuar aplikacionin për Certifikatë të Sigurisë nga ana e Trainkos

Për herë të parë në historinë e Hekurudhave të Kosovës kemi filluar që këtë kompani ta pajisim me Certifikatë të Sigurisë sipas standardeve të përcaktuara nga Agjensioni Evropian i Hekurudhave-ERA(European Railëay Agency).

Aplikimi për Autorizim të Sigurisë nga Menaxheri i Infrastrukturës Infrakos

Pas përmbylljes me sukses të të gjithë procesit të konsultimeve, përgatitjes së formularëve standard për aplikim sipas versionit të përdorur në ERA, përgatitjes së formularit për Autorizim të Sigurisë në gjuhën shqipe ne me datë 12.12.2012 kemi pranuar Aplikimin për Autorizim të Sigurisë nga Menaxheri i Infrastrukturës Infrakos, me çka edhe e kemi filluar procesin e vlerësimit të këtij aplikacioni, ku presim që deri ka fundi i muajit janar 2013 ta përfundojmë këtë proces me sukses dhe Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos t'i jipet Autorizimi i Sigurisë pjesa A dhe B.

Me datë 12.12.2012, kemi pranuar aplikacionin për Autorizim të Sigurisë nga ana e Infrakosit.

Gjatë muajit nëntor Infrakos ka dorëzuar draftin e SMS (Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë) më këtë rast kemi bërë një vlerësim paraprak nga ana e departamentit të Sigurisë.

Për herë të parë në historinë e hekurudhave të Kosovës kemi filluar që këtë kompani ta pajisim me Autorizim të Sigurisë sipas standardeve të përcaktuara nga Agjensioni Evropian i Hekurudhave ERA (European Railëay Agency).

DEPARTAMENTI I INTEROPERABILITETIT

Departamenti i Interoperabilitetit krijuar sipas Ligjit 04/L-63 për Hekurudhat e Kosovës ka filluar punën që nga 09/02/2012.

Ky është raporti i parë për Interoperabilitet hekurudhor. Ky raport mbulon të dhëna për vitin 2012 në formë të përmbledhur, të aktiviteteve dhe rezultateve që Departamenti i Interoperabilitetit brenda ARH-së ka zhvilluar për këtë periudhë

Definicioni

Interoperabiliteti është një iniciativë e Bashkimit Evropian për promovimin e një tregu të vetëm në sektorin hekurudhor. Kjo iniciativë evropiane është e dizajnuar për të përmirësuar pozitën konkurruese të sektorit hekurudhor, kështu që ajo të mund të konkurrojë në mënyrë më efektive me format e tjera të transportit. Këtë e bënë përmes një kuadri rregullator që nxitë harmonizimin teknik dhe standardizimin e hekurudhave të Evropës.

- Interoperabiliteti është aftësi e Infrastrukturës Hekurudhore të Kosovës që të lejojë lëvizjen e sigurt dhe të pandërprerë të trenave konvencional brenda dhe jashtë Kosovës që kryejnë nivele të specifikuara të performancës për linjat.
- Kjo aftësi qëndron mbi të gjitha në konditat rregullatore dhe teknike, si dhe kushtet operacionale të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të përmbushen kërkesat thelbësore.
- Parashikon standardet e përbashkëta teknike të quajtura Specifikime Teknike për Interoperabilitet STI, që të aplikohen në të gjithë rrjetin hekurudhor brenda dhe jashtë Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta, departamenti udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-63 dhe sipas dispozitave të Direktivës 2008/57/EC për Interoperabilitet dhe Direktivës 2004/49/EC.

Departamenti i Interoperabilitetit është përgjegjës t'i përcaktoj kushtet të cilat duhet t'i plotësoj sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur Interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së në drejtim të krijimit të hapësirës së Interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës synon të jetë edhe Kosova.

Departamenti ka për detyrë të përgatitë legjislacionin sekondar në fushën e Interoperabilitetit Hekurudhor i cili duhet të jetë në përputhje me standardet dhe rregullat evropiane të përcaktuara nga Direktivat për Interoperabilitet.

Kushtet në lidhje me Interoperabilitetin përmbajnë: dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin, mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit, kualifikimet profesionale, kushtet e shëndetit, sigurisë së stafit i cili kontribuon për operimet dhe mirëmbajtjen e tij.

Organi i pavarur për Interoperabilitet duhet të jetë përgjegjës në Kosovë për të siguruar që sektori hekurudhor përputhet dhe do të përputhet në të ardhmen me kërkesat për interoperabilitet siç janë definuar nga Direktivat dhe Rregulloret e BE-së, e në veçanti me Rregulloret e Agjencionit Evropian Hekurudhor-ERA (European Railway Agency)

Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit

Më datë 05.12.2012 është përfunduar Regjistrimi Nacional i Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore.

Legjislacioni në fuqi kërkon :

Harmonizimin e legjislacionit, rregullave dhe të standardeve në sektorin hekurudhor me ato të BE-së të përshtatshme për Kosovën.

Janë këto aktivitete të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar në vazhdim të këtij raporti:

Regjistrimi i Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore

Sipas Direktivës së BE-së mbi Interoperabilitetin e Sistemit Hekurudhor 2008/57/EC, çdo shtet duhet të mbajë një regjistër të mjeteve lëvizëse të autorizuar në territorin e saj për ta ndërlidhur atë me Regjistrin Qëndror Evropian të llojeve të autorizuar të mjeteve lëvizëse.

Në Kosovë detyra e mbajtjes së Regjistrit Nacional të Mjeteve Lëvizëse hekurudhore-NVR (Nacional Vehicle Register) i është caktuar ARH-së, Departamentit të Interoperabilitetit sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës i cili ka për detyrë të organizojë këtë regjistër dhe për t'i futur të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore që janë në shërbim në Kosovë brenda këtij regjistri.

Kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm për fillimin e procesit të regjistrimit

- **Përgatitja e rregullores për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore 05/2012**

Për të specifikuar më qartë rregullat për procesin e regjistrimit dhe shenjëzimin e mbajtësit të mjetit lëvizës, Departamenti i Interoperabilitetit në bashkëpunim me Departamentin Ligjor ka hartuar Rregulloren 05/2012 për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore

Aktualisht Kosova nuk posedon kodin shtetëror Hekurudhor, kod i cili qëndron si e dhënë bazë brenda formularit për aplikimin e mjeteve lëvizëse. Kështu që në bashkëpunim me operatorët hekurudhor është vendosur që përkohësisht të vendoset një kod hekurudhor i identifikuar si „00„

- **Përgatitja e formularit standard për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse hekurudhore**

Formulari në detaje kërkon të dhëna bazë për mjetin lëvizës hekurudhor. Kriteret e përcaktuara në formularin e përshkrimit, kanë një lidhje shumë të qartë dhe të ngushtë logjike me kriteret e përcaktuara për t'u marrë në konsideratë.

Është formë e harmonizuar dhe adaptuar nga Agjencioni Evropian i Hekurudhave.

○ **Prezantimi-Instruksionet për procesin e regjistrimit të mjeteve lëvizëse**

Është përgatitur një prezantim për procedurat e regjistrimit të mjeteve lëvizëse, një procedurë e qartë për këtë proces dhe për më tepër një model i shoqëruar me një metodologji shpjeguese shumë të detajuar.

 Procesi i Regjistrimit të Mjeteve Lëvizëse

Fillimi i procesit të regjistrimit i është konfirmuar Operatorëve Hekurudhor përmes shkresave zyrtare.

Konfirmimi i pranimit të aplikacioneve për regjistrimin e mjeteve lëvizëse përmes shkresave zyrtare

FERRO-NICKEL-it më dt.15.10.2012

TRAINKOS-it më dt.24.09.2012

INFRAKOS-it më dt.25.10.2012

Aplikacionet e INFRAKOS-it për Regjistrimin e mjeteve lëvizëse për mirëmbajtje janë pranuar në Departamentin e Interoperabilitetit më datë **23.10.2012**.

Aplikacionet E FERRONIKEL-it për Regjistrimin e mjeteve lëvizëse janë pranuar në Departamentin e Interoperabilitetit më datë **15.10.2012**.

Aplikacionet e TRAINKOS-it për regjistrimin e mjeteve lëvizëse janë pranuar në Departamentin e Interoperabilitetit më datë **21.09.2012**

Departamenti i Interoperabilitetit ka shqyrtuar aplikacionet konform dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, Rregullorës për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse 05/2012 si dhe Vendimin 2007/56 EU.

Gjatë shqyrtimit të aplikacioneve në mënyrë të detajuar janë ngritur disa shqetësime si dhe janë kërkuar informacione shtesë.

Departamenti i Interoperabilitetit në mbështetje të dispozitave ligjore përmes shkresave zyrtare më dt. 05.12.2012 njofton Operatorët Hekurudhor se tashmë mjetet e tyre lëvizëse janë të regjistruara në Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse-NVR (Nacional Vehicle Register)

Bashkëpunimi në mes të ARH-së me Infracos-in, Trainkos-in dhe Ferro-Nickel-in ishte shumë konstruktiv i cili ndihmoi në krijimin e këtij regjistri. Andaj ne si ARH i kemi mbështetur plotësisht në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e përpikt të mjeteve lëvizëse.

ARH-ja tashmë ka në dispozicion Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore për herë të parë në Kosovë.

Tabela në vijim paraqet Operatorët Hekurudhor - mjetet lëvizëse të të cilëve janë në Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore.

OPERATORI HEKURUDHOR	AKRONIMI	STATUSI	Webfaqja
Infrastruktura Hekurudhore e Kosovës	INFRAKOS	Në përdorim	www.kosovorailëay.com
Operimi me trena në Kosovë	TRAINKOS	Në përdorim	www.trainkos.com
Newco Ferronikeli Complex L.L.C	FERRONIKEL	Në përdorim	www.cunicoresources.com

Shënjëzimi i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës – VKM (Vehicle Keeper Marking)

VKM-ja është pasqyrim i emrit të plotë apo shkurtesës së mbajtësit të mjetit lëvizës. Një shënjëzim i mbajtësit të mjetit lëvizës (VKM) është një kod alfanumerik i përbërë prej 2 deri në 5 karaktere. Një VKM duhet të jetë i mbishkruar në secilin mjet lëvizës hekurudhor, afër numrit të mjetit lëvizës.

ARH-ja, përgjegjës për Interoperabilitet, përcakton kodet në vijim për VKM-në në marrëveshje me Ndërmarrjet Hekurudhore / Menaxherët e Infrastrukturës / Mbajtësin e Mjetit Lëvizës

Departamenti i Interoperabilitetit në përputhje me Vendimin 2011/314/EU ka zhvilluar procedurat për aplikimin e operatoreve hekurudhor për kodin e VKM-së, duke e bërë këtë përmes rregullave të paraqitura dhe përgatitjes së formularit standard për aplikimin e kodit të VKM-së.

Formulari standard për Shënjëzimin e mbajtësit të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore është i harmonizuar dhe adaptuar nga Agjencioni Hekurudhor European (ERA).

Aplikacioni i INFRAKOS-it për Kodin e VKM-së janë pranuar në Departamentin e Interoperabilitetit më datë **22.11. 2012.**

Aplikacioni i TRAINKOS-it për Kodin e VKM-së janë pranuar në Departamentin e Interoperabilitetit më datë **16.11. 2012.**

Aplikacioni i FERRONIKEL-it për Kodin e VKM-së janë pranuar në Departamentin e Interoperabilitetit më datë **22.11. 2012.**

Shenja e nacionalitetit të Mjeteve Hekurudhore të regjistruara në Kosovë e cila qëndron si e dhënë bazë brenda formularit është **KS**.

Pranimi i kodeve të VKM-së të rekomanduara nga INFRAKOS-i, TRAINKOS-i dhe FERRO-NICKELI për të cilat kanë aplikuar është bërë përmes shkresave zyrtare më dt. 05.12.2012

Lista alfabetike e kodeve të VKM-së

	VKM	UNIKE	STATUS		
Sqarime:	Kodi që shihet në mjetin lëvizës	Kontrollimi i kodeve unike	Blokuar	Në përdorim	Revokuar

VKM	UNIKE	Emri i VKM	Shenj.nac.	Statusi	Webfaqja
IHK	IHK	Infrastruktura hekurudhore e Kosovës	KS	Në përdorim	www.kosovorailëay.com
NCF	NCF	Newco Ferronikeli Complex L.L.C	KS	Në përdorim	www.cunicoresources.com
TRKOS	TRKOS	Operimi me trena në Kosovë	KS	Në përdorim	www.trainkos.com

Krijimi i listës së plotë të STI-së, Specifikimeve Teknike për Interoperabilitet

Specifikimet Teknike për Interoperabilitet (STI) do të thotë specifikimet me të cilat çdo nënsistem ose pjesë e nënsistemit është e mbuluar në mënyrë që të plotësojnë kërkesat thelbësore dhe për të siguruar Interoperabilitetin e sistemeve konvencionale

ARH-ja në fazën e fundit të vitit 2012 ka përgatitur listën e Specifikimeve Teknike për Interoperabilitet të hartuara dhe nxjerra nga Agjencioni Hekurudhor Evropian .

Tabela në vijim ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale të STI-së

Sistemi hekurudhor konvencional				
Nënsistemi	STI	Nr.dokum.	Dokument	Publikimi
Kontrolla e komandës dhe sinjalizimit (CCS)	CR TSI CCS	2006/679/EC	Vendim	2006
	CCS Modifikim	2006/860/EC	Vendim	2006
	CCS Modifikim	2007/153/EC	Vendim	2007
	CCS Modifikim	2008/386/EC	Vendim	2008
	CCS Modifikim	2009/561/EC	Vendim	2009
	CCS Modifikim	2010/79/EC	Vendim	2010
Mjetet lëvizëse-zhurma (NOI)	CCS	2012/88/EC	Vendim	2012
	CR TSI NOI	2006/66/EC	Vendim	2006
	NOI Rishikim I pjesërisht	2011/229/EC	Vendim	2011
NOI Amendament		2012/464/EC	Vendim	2012

Aplikacionet telematike për transportin e pasagjerëve E RE	TSI TAP	Reg (EC) 454/2011	Rregullore	2011
	TAP Amendment	Reg(EC)662/2012	Rregullore	2012
Mjetet lëvizëse-Aplikacionet telematike për transportin e mallrave(TAF) E RE	TSI TAF	Reg (EC) 62/2006	Rregullore	2006
	Amendment	Reg(EC)328/2012	Rregullore	2012
Mjetet lëvizëse-vagonat për transportin e mallrave (ËAG) E RE	CR TSI ËAG	2006/861/EC	Vendim	2006
	WAG Amendment	2009/107/EC	Vendim	2009
	Rishikim pjesërisht			
	WAG Amendment	2012/464/EC	Vendim	2012
Operacioni dhe menaxhimi i trafikut (OPE) E RE	CR TSI OPE	2006/920/EC	Vendim	2007
	OPE Amendment	2009/107/EC	Vendim	2009
	OPE Amendment	2010/640/EC	Vendim	2010
	OPE Revision	2011/314/EC	Shtojcë P9 Shtojcë A Vendim	2011
	OPE Amendment	2012/464/EC	Vendim	2012
Energjia (ENE) E RE	CR TSI ENE	2011/274/EC	Vendim	2011
	ENE Amendment	2012/464/EC	Vendim	2012
Infrastruktura (INS) E RE	CR TSI INF	2011/275/EC	Vendim	2011
	INF Amendment	2012/464/EU	Vendim	2012
Lokomotivat dhe mjetet lëvizëse për transportin e pasagjerëve (LOC PAS)	CR TSI LOC PAS	2011/291/EC	Vendim	2011

Entitetet përgjegjëse për mirëmbajtje hekurudhore

ARH-ja mban regjistrin e entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtje hekurudhore

Secili mjet i transportit para se të hyj në shërbim ose të përdoret në rrjet duhet të ketë një entitet të ngarkuar për mirëmbajtje dhe ky entitet duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e mjeteve të transportit të autorizuar në Kosovë.

Aktualisht në Kosovë ekzistojnë dy entitete përgjegjëse për mirëmbajtje hekurudhore që ofrojnë shërbime për mirëmbajtjen e Infrastrukturës dhe mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse .

Lista e entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtje hekurudhore

ENTITETI	SHTETI	SHËRBIMET	WEBFAQJA
INFRAKOS	00	INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS SHËRBIMET PËR MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS	www.kosovorailway.com
TRAINKOS	00	OPERIMET ME TRENA TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS SHËRBIMET PËR MIRËMBAJTJEN E MJETEVE LËVIZËSE	www.trainkos.com

Bashkëpunimi Ndërinstitucional

ARH-ja, përgjegjës për Interoperabilitet ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse për transportin hekurudhor dhe palët tjera të interesit në Republikën e Kosovës në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës të funksionoj i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira rajonale dhe evropiane.

Objektivi i Interoperabilitetit Hekurudhor

Ndjekja e këtij objektivi duhet të qoj në përcaktimin e një niveli optimal në harmonizimin teknik dhe të bëjë të mundur për të lehtësuar përmirësimin dhe zhvillimin e shërbimeve të transporti hekurudhor brenda dhe jashtë vendit .



DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT Ë TREGUT

Departamenti i Rregullimit të Tregut ka filluar së funksionuari që nga Prill 2012

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr.04/L-063 neni 25 pika 6.1 Departamenti përgjegjës për Rregullimin e Tregut Hekurudhor në kuadër të ARH-së, përpilon këtë raport vjetor në lidhje me Rregullimin e Tregut, ku do të përshkruajmë të arriturat kryesore gjatë vitit 2012 dhe detyrat që na presin gjatë vitit 2013.

Departamenti i Rregullimit të Tregut fillimisht ka filluar punën me pozitën e Kryesuesit të Departamentit të Rregullimit të Tregut. Kjo është koha prej kurë kemi filluar të funksionojmë si Departament, pastaj ka filluar së kompletuari me stafin profesional nga Tetori me pozitën e Zyrtarit të Rregullimit të Tregut.

Detyrat dhe përgjegjësit

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-063 më datë 01.01.2012, Departamenti i Rregullimit të Tregut Hekurudhor është përgjegjës për :

- Sigurimi që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese,
- Sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese,
- Mbikëqyrja e negociimeve ndërmjet aplikuesëve dhe menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Ato negociata duhet të lejohen vetëm nëse ato kryhen nën mbikëqyrjen e Departamentit të Rregullimit të Tregut Hekurudhor.
- Intervenimi nëse negociatat e tilla kanë të ngjarë se do jenë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji,

- Sigurimi se a përmban ekspozeti i rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët,
- Analizimi dhe monitorimi i konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në tregun e shërbimeve hekurudhore dhe në tregjet e brendshme dhe të jashtme konkurruese. E gjithë kjo të bëhet me iniciativën e tij dhe me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve.

Aktivitetet e Departamentit të Tregut

Komentimi dhe Plotësimi i Draft- Ekspozetit të Rrjetit 2013

Me fillimin e punës kryesisht jemi fokusuar në analizimin e Ligjit 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, me fokus të veçantë në rregulloret për Rregullim të Tregut, pastaj kemi filluar të njoftohemi më hollësisht me materialet të cilat na nevojiten për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Tregut në sektorin hekurudhor siç janë:

- Analizimi i Ligjit 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës
- Direktiva 2001/14/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (për Rregullimin e Tregut Hekurudhor)
- Përpunimi i materialit të dërguar nga Ministria e Infrastrukturës: Përkrahja në Zbatimin e Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit EU-TCA
- Përpunimi i materialit të dërguar nga Ministria e Infrastrukturës: 2012-2021 Strategjia e Transportit Multimodal dhe Azhurnimi Planit të Veprimit 2012-2016,

Shqyrtimi i Ankesës së Trainkos-it për Ekspozeun e Rrjetit 2013 nga Departamenti i Tregut

Në maj të vitit 2012 Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor ka pranuar draft Ekspozeun e Rrjetit 2013 prej Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos SH.A prej kur edhe kemi filluar një proces intensiv të konsultimeve duke përfshirë të gjitha palët e interesit siç janë: ARH, Infrakos, Trainkos, MI, MZHE.

Departamenti i Rregullimit të Tregut me datë 26.05.2012 ka pranuar draft Ekspozeun e Rrjetit 2013 nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos SH.A

Pas marrjes së draft Ekspozeut të Rrjetit nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos SH.A në muajin maj kemi pranuar Ankesë nga Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos SH.A. me datë 31.05.2012. Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor në kuadër të ARH-së menjëherë ka filluar me përgatitjet për shqyrtimin e ankesës së Trainkos SH.A.

Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos në ankesën e drejtuar ARH-së kishte disa vërejtje për draft Ekspozeun e Rrjetit 2013 siç janë:

- Mungesa e procesit të konsultimit gjatë përgatitjes së draftit të Ekspozeut të Rrjetit 2013,
- Niveli shumë i lartë i tarifave,
- Niveli i koeficienteve në formulën për llogaritjen e tarifave,
- Deformimi i konceptit të kostos direkte të llogaritur në çmim,
- Deformimet në kategoritë tjera të shërbimeve që ofron Infrakos.

Departamenti i Rregullimit të Tregut më datë 31.05.2012 ka pranuar ankesën për draft Ekspozeun e Rrjetit 2013 nga Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos SH.A

Procesi i Konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit 2013

Me datë 26.06.2012 Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor ka mbajtur një takim zyrtar me Infrakos, Trainkos, MI, MZHE, ku janë zhvilluar konsultime intensive lidhur me draftin e Ekspozeut të Rrjetit 2013.

Departamenti i Rregullimit të Tregut më datë 26.06.2012 dhe më 28.06.2012 ka mbajtur takim me grupin punues nga Infrakos, Trainkos, MI, MZHE për procesin e konsultimeve për draft Ekspozeun e Rrjetit 2013.

Si temë specifike ka qenë kapitulli i gjashtë (6) i Ekspozeut të Rrjetit me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, gjegjësisht mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos.

Me datë 28.06.2012 Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor ka mbajtur një takim me grupin punues nga Infrakos, Trainkos, MI, MZHE, ku kanë vazhduar konsultimet lidhur me draftin e Ekspozeut të Rrjetit 2013, ku palët e interesit kanë shprehur opinionet dhe argumentet e tyre për dhe kundër Ekspozeut të Rrjetit 2013. Infrakos ka argumentuar të dhënat e futura në këtë Ekspoze ku sipas tyre këto janë çmimet reale për mirëmbajtje të Infrastrukturës Hekurudhore, Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos në këtë takim ka paraqitur vërejtjet e tyre lidhur me Ekspozeun e Rrjetit 2013, posaçërisht ka pasur Ankesa për pikat e përmendura më lartë sidomos për kapitullin (6) që ka të bëjë me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, gjegjësisht mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos.

Departamenti për Rregullimin e Tregut pas këtij takimi ka filluar të punoj në nxjerrjen e fakteve lidhur me ankesën e paraqitur nga ana e Trainkos-it, për çmimet e operimit në Infrastrukturën hekurudhore si dhe krahasimin me atë të vendeve fqinje siç janë: Maqedonia dhe Mali i Zi.

Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor pas një procesi të gjithanshëm të konsultimeve me palët e interesit me datë 19.07.2012 ka marrë vendim për çështjet e ngritura për draft Ekspozeu i Rrjetit 2013 siç janë:

- Mungesa e procesit të konsultimit gjatë përgatitjes së draftit të Ekspozeut të Rrjetit 2013,
- Niveli shumë i lartë i tarifave,
- Niveli i koeficienteve në formulën për llogaritjen e tarifave,
- Deformimi i konceptit të kostos direkte të llogaritur në çmim,
- Deformimet në kategoritë tjera të shërbimeve që ofron Infrakos.

Departamenti i Rregullimit të Tregut më datë: 19.07.2012 ka marrë Vendim lidhur me ankesën e Trainkos-it për çështjet e paraqitura në ankesë:

Në Vendimin Nr. 169, datë 19.07.2012 thuhet se:

ARH ka analizuar situatën e tregut bazuar në informacionet të cilat i kemi pranuar dhe vjen në përfundim se: Tarifat e infrastrukturës janë të larta dhe ato rrezikojnë rritjen e konkurrencës në sistemin hekurudhor të Kosovës dhe ARH kërkon nga Infrakos që të rishqyrtojë kalkulimin e koeficientëve për llogaritjen e çmimit.

Me datë 08.08.2012, Ministria e Infrastrukturës ka marrë Vendim lidhur me miratimin e kapitullit të 6 (çmimet) të Ekspozeut të Rrjetit 2013, ku thuhet se:

- Miratohet struktura e sistemit të vendosjes së çmimit për shfrytëzuesit e rrjetit dhe nivelin e përgjithshëm të pagesave të shfrytëzimit të infrastrukturës hekurudhore, e përcaktuar në Ekspozeun e Rrjetit 2013,
- Numri i vendimit, data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe modifikimet e ndryshme shënohen në tabelën e modifikimeve të Ekspozeut të rrjetit.

Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor ka përgatitur draft Udhëzimin Administrativ detajimin e kostos direkte në lidhje me mirëmbajtjen e infrastruktures dhe operimin e shërbimeve të trenit, ky draft është dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës për nënshkrim.

Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor ka përgatitur dhe punuar draft propozimin për rregulloren e brendëshme për “Rregullim të Tregut” dhe pritet shqyrtimi dhe miratimi nga Bordi i ARH-së.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i Administratës ofron mbështetje të gjithanshme për personelin e ARH-së luke përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore, prokurimin, TI-në dhe logjistikën.

Departamenti i Administratës drejtpërdrejt është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit administrativ të ARH-së. Në mënyrë efektive ka menaxhuar administrimin e aktiviteteve të burimeve njerëzore siç janë: administrimi i kohës dhe prezencës në punë, rekrutimi, vendosja e shpalljeve për punë, vlerësimet e punës së stafit në kuadër të Departamentit, etj.

Departamenti i Administratës ka ofruar përkrahje administrative sipas nevojës.

Aktivitetet e Departamentit të Administratës

- Procedurat për rekrutimin e shërbyesve civil për katër pozitat e aprovuara për institucionin e ARH-së me 31/07/2012 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
 - Asistent për Interoperabilitet
 - Zyrtar i Lartë i Prokurimit
 - Asistent për Siguri
 - Zyrtar i Tregut
 - Zyrtar Ligjor
- Përfundimi i suksesshëm i rekrutimit për pozitat: Zyrtar Ligjor, Asistent i Interoperabilitetit, Asistentit i Sigurisë, Asistent i Interoperabilitetit dhe Zyrtar i Lartë i Prokurimit.
- Dorëzimi i formularëve në MAP për aprovimin e pranimit të pozitave dhe sistemimi në listën e pagave,
- Negocimi dhe përtëritja e kontratës për qera për objektin e ARH-së si dhe procedurat e tenderimit për sigurim fizik të objektit të ARH-së dhe mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit,
- Evidentimi i pushimeve vjetore dhe mjekësore për stafin e punëtorëve të ARH-së sipas Rregullores për Nëpunësit Civil.
- Organizimi i trajnimeve të nevojshme për stafin e ARH-së.

DEPARTAMENTI I FINANCIVE

Duke njohur nevojën për përmirësimin e shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësiwe buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar, Departamenti i Financave të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave vepron dhe operon në bazë të: Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

Në kuadër të ARH-së, Departamenti i Financave ka përgatitur dhe paraqitur Pasqyrat Financiare brenda afateve ligjore, ku në to janë përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2012 të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", që i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048 dhe Ligjin Nr. 03/L-221 për ndryshim plotësimin e LMFPP ku janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Aktivitetet e Departamentit të Financave:

- Menaxhimi dhe Mbikëqyrja e Financave dhe Buxhetit të ARH-së për vitin 2012
- Angazhimi dhe kontributi gjatë planifikimit të buxhetit
- Mbikëqyrja e Zotimeve, Shpenzimeve dhe Certifikimeve të lëndëve në sistem të Free Balanc-it
- Përgatitja e raporteve financiare
- Përgatitja e raporteve standarde të të hyrave dhe shpenzimeve
- Nxjerrja e raporteve, analiza dhe shqyrtimi i bilanceve dhe shërbimeve të përgjegjësisë financiare
- Mbarëvajtja e procedurave dhe sistemeve adekuate financiare të BKK-së, përfshirë sistemin e pagesës së rrogave dhe shtesave të punëtorëve
- Mbajtja e llogarisë së kontabilitetit në mënyrë te pavarur
- Krijimi i sistemit funksional të raportimit financiar për mbikëqyrësin
- Mirëmbajtja e llogarive dhe faturave
- Koordinimi i shënimeve dhe menaxhimi i Arkës (Petty Cash-it) në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048
- Koordinimi dhe përgatitja e të gjitha raporteve të çmimeve dhe shpenzimeve

Kështu që ne kemi konfirmuar për sa kemi pasur njohuri dhe besim që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës kanë qenë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave kanë qenë të sakta.
- Nuk ka pasur llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2012.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të Autoriteteve Rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare, në rast se do të shkeleshin.
- Nuk ka pasur ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huat për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Prandaj, Pasqyrat Financiare të konsoliduara nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave-ARH kanë paraqitur një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të Financave dhe transaksioneve financiare për vitin 2012

Andaj për të qartësuar pozicionimin financiar të ARH-së ne do të shpalosim informatat e plota dhe të qarta të cilat do të jenë paraqitje financiare për vitin 2012 ku rrjedhshmëria e punëve dhe shërbimeve sipas kategorive gjatë këtij viti ka qenë:

Paga dhe Mëditje: Në bashkëpunim me personelin rrjedhshmëria dhe paraqitja e listë-pagave, formularëve për punëtorë të rinj, retroaktivet, formularët për ndryshime janë paraqitur çdoherë sipas afateve kohore të përcaktuara me ligj

Mallra dhe Shërbime: Rrjedhshmëria e shpenzimeve ka qenë sipas planifikimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara me ligj dhe të gjitha procedurat për pagesa janë zhvilluar sipas rregullave dhe kritereve të lejuara

Shpenzime Komunale: Rritja e shpenzimeve nga kjo kategori gjatë këtij viti ka qenë paralelisht me rritje të stafit që përndryshe do të thotë ka pasur ndikime të rritjes së shpenzimeve përmes rritjes së hapësirave të punës dhe shtimit të nevojave për shfrytëzimin e shërbimeve tjera komunale

Subvencione: Nuk kemi pasur subvencione gjatë këtij viti as nga Qeveria as nga Donatorët apo ndonjë nivel tjetër

Shpenzime kapitale: Nga kjo kategori kemi pasur shpenzime për blerje të veturës zyrtare për nevoja të institucionit mirëpo kërkohet përkrahja nga niveli qendror për projekte të tjera kapitale dhe njëkohësisht mbetet obligim i periudhës së ardhshme

Për një sqarim të përgjithshëm do të japim një gjendje të përgjithshme financiare dhe një ndarje krahasuese për të gjitha kategoritë buxhetore duke paraqitur të dhënat e vitit paraprak të cilat na japin një pasqyrë më të mirë, më të qartë dhe më me vizion për të ardhmen e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Ndarjet buxhetore në Total nga të gjitha Kategoritë Buxhetore, Varianca dhe Krahasset

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për **ARH**
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2012

		2012		2011		2010	
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Varianca D=C-B	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
Shënime		€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Tatimet	14						
Të hyrat vetanake	15						
Donacionet	16						
Pranimet kapitale	17						
Fondi i Privatizimit	18						
Huazimet	19						
Tjera	20						
Pranimet totale të mbledhura për FKK-në		-	-	-	-	-	-
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	21	101,497	121,449.00	106,205.25	15,243.75	73,514.67	34,119.65
Mallrat dhe shërbimet	22	76,013	95,513.00	95,499.73	13.27	68,434.99	77,913.93
Shërbimet komunale	23	14,000	6,000.00	5,859.52	140.48	5,086.94	81.74
Transferet dhe subvencionet	24				-		
Shpenzimet kapitale	25	20,000	20,000.00	17,855.00	2,145.00		
Fondi i privatizimit	26						
Kthimi i huazimeve							
Tjerat	27						
Totali i pagesave i bërë nga BRK nëpërmes LIVTh		211,510	242,962.00	225,419.50	17,542.50	147,036.60	112,115.32

*(&AQQ

Paga: Kemi një realizim të buxhetit prej 87.45%

Përshkrimi	2012				2011	2010
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Neto pagat		89,295.69	-	89,295.69	61,980.31	27,760.82
Pagesat për sindikata -0.10% te 0.50%						
Pagesa neto për punë jashtë orarit						
Pagesa për punë me orar të shkurtuar						
Pagesa për punë në ndërrim të natës						
Pagesa neto për pushim të lehonisë						
Mëditjet e delegatëve dhe komisioneve						
Punëtorët me kontratë						
Tatimi në të ardhura personale		6,794.62	-	6,794.62	4,532.80	2,497.40
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		5,057.47	-	5,057.47	3,500.78	1,624.75
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		5,057.47	-	5,057.47	3,500.78	1,624.75
Shujtat						611.93
Gjithsej Pagesat	-	106,205.25	-	106,205.25	73,514.67	34,119.65

Mallra dhe Shërbime: Kemi një realizim të buxhetit prej 99.99 %

Përshkrimi	2012				2011	2010
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Shpenzimet e udhëtimit	26,794.61			26,794.61	6,818.62	10,720.04
Shërbimet e telekomunikimit	6,500.00			6,500.00	4,080.00	3,715.00
Shpenzimet për shërbime	21,414.00			21,414.00	18,982.50	10,201.06
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	3,772.00			3,772.00	805.00	35,342.00
Mobiljet dhe pajisjet tjera 1000 - 5000 Euro						
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	1,709.58			1,709.58	7,182.76	5,320.75
Derivatet dhe lëndët djegëse	3,977.73			3,977.73	5,073.59	390.38
Shërbimet financiare						
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	7,032.18			7,032.18	535.50	
Mungesa në arkë-kthimet						2,179.76
Mirëmbajtja	3,749.23			3,749.23	6,080.24	
Qiraja	17,875.00			17,875.00	16,250.00	2,491.00
Shpenzimet e marketingut	1,632.40			1,632.40	1,711.18	7,442.14
Shpenzimet e përfaqësimit	1,043.00			1,043.00	915.60	111.80
Vendimet e gjykatave						
Tatimi						
Servisimi i borxhit						
Gjithsej Pagesat	95,499.73	-	-	95,499.73	68,434.99	77,913.93

Shpenzime Komunale:Kemi një realizim të buxhetit prej 97.66%

Përshkrimi	2012				2011	2010
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Rryma	1,911.73			1,911.73	2,186.10	81.74
Uji						
Telefon	3,947.79			3,947.79	2,900.84	
Gjithsej Pagesat	5,859.52	-	-	5,859.52	5,086.94	81.74

Të Hyrat vetanake

Përshkrimi	Shënime	2012	2011	2010	% e totalit 2012	% e ndryshimit nga 2010
		€	€	€		
Të hyrat nga taksat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga taksat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria e ARH-së					%	%
Pranimet tjera të ARH-së					%	%
Totali		0	0	0	0%	%

Ne si ARH ende nuk kemi filluar inkasimin e mjeteve përmes Taksave, Gjobave, Licencave, Lejeve të Sigurisë dhe pranimet tjera si të Hyra Institucionale

Subvencione dhe Transfere

Përshkrimi	2012				2011	2010
	GQ	THV	GPD	Totali		
	€	€	€	€	€	€
Pagesat						
Subvencionet për entitetet publike						
Subvencionet për entitetet kulturore						
Subvencionet për entitetet jo-publike						
Transfere për qeveri tjera						
Pagesat për përfituesit individualë						
Pensionet bazë						
Pensionet invalide						
Pensionet ose ndihmat sociale						
Pensionet e TMK-së						
Pensionet e kategorisë I (anëtarët e familjes)						
Pensionet e kategorisë II (anëtarët e familjes)						
Pagesat për invalidët e luftës						
Pagesat për invalidët civilë						
Pagesat për familjet e viktimave të luftës						
Pensionet e përkohshme të Trepçës						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

Ne si ARH gjatë vitit 2012 nuk kemi patur ndonjë Subvencionim apo transfer Qeveritar

Shpenzimet Kapitale

Përshkrimi	2012				2011	2010
	GQ	THV	GPD	Totali		
	€	€	€	€	€	€
Pagesat						
Ndërtesat					-	-
Ndërtimi i rrugëve					-	-
Kanalizimi					-	-
Ujësjetllësi					-	-
Energjia, gjenerimi, bartja dhe furnizimi					-	-
Pajisje mbi 1000 Euro					-	-
Automjete transporti						
Makineria-Blerja e veturës zyrtare		17,855		17,855		
Kapitalet tjera					-	-
Toka						
Pasuritë e paprekshme						
Transferet kapitale për entitetet publike						
Transferet kapitale për entitetet jopublike						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	17,855	-	-	17,855	-	-

ARH –ja gjatë vitit 2012 ka realizuar vetëm blerjen e veturës zyrtare ndërsa në projekte tjera kapitale ende nuk kemi pasur mbështetjen nga niveli qendror ku si nevoja kemi identifikuar me kohë dhe kemi paraqitur projektet për këtë kategori

Projekti i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian (ZBE)

Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte që të mbështesë zbatimin e reformave në sektorin Hekurudhor të Kosovës përderisa si çështje specifike ka përfshirë draftimin e legjislacionit sekondar në fushën hekurudhore si dhe ndërtimin e kapaciteteve për stafin e ARH-së (ngritje institucionale).

Ekipi i projektit të financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian (ZBE) ka filluar punën nga muaji Mars 2012 deri në Nëntor 2012

Aktivitetet e parashikuara në kuadër të këtij projekti, u realizuan në kohë dhe sipas parashikimeve të termave të referencës.

Workshop-i i organizuar nga TAIEK (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit) në bashkëpunim me ARH-në

Workshop-i me temën „Pasojat e ndryshimit të pakos së parë hekurudhore në zonën e Ballkanit Perëndimor,, është mbajtur më datë 17.10.2012 në Prishtinë.

Qëllimi i workshop-it në lidhje me “Pasojat e ndryshimit të paketës së parë hekurudhore në zonën perëndimore të Ballkanit” ishte që të paraqesë aspekte të legjislacionit të BE për një audiencë më të gjerë, si dhe për të shpjeguar çështje legjislative brenda Direktivës.

Pjesëmarrës nga Institucionet vendore:

ARH-Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

MI-Ministria e Infrastrukturës

INFRAKOS-Menaxheri i Infrastrukturës

Pjesëmarrës nga :

Komisioni Evropian

MC Mobility Consultants-Viena

Workshop-i rezultoi të jetë tematikë që lidhet me legjislacionin në substancë, diskutime më praktike që kanë të bëjnë me sektorin hekurudhor dhe zbatimin e acquis. U adresuan nevojat e vendeve që përballen me sfida të ngjashme. Workshop-i u ndoq nga pjesëmarrësit nga institucionet vendore si dhe përfaqësues nga vendet Anëtare të marrëveshjes së SEETO-së (Observatori për Evropën Juglindore)

Përfaqësues nga vendet Anëtare të marrëveshjes së SEETO-s:

Agjensioni publik i Hekurudhave-Sllovenija.

Hekurudhat Shqipëtare-Shqipëri

Ministria e Transportit dhe Komunikacionit-Maqedoni

Agjensioni Rregullator i Sektorit Hekurudhorë-Maqedoni

Hekurudhat e Malit të Zi-Mali i Zi

Workshop për llogaritjen e kostos direkte

Në muajin gusht është mbajtur workshop-i për koston direkte përkatësisht seminari me konsulencën ndërkombëtare, me ekspertët për llogaritjen e koston direkte dhe koeficientëve me Temën “Aplikimi i koston direkte në llogaritjen e tarifave të infrastrukturës” në lidhje me Udhëzimin e BE-së 2001/14EC dhe Ligjin mbi Hekurudhat. Seminari u mbajt prej datës:14.08.2012 deri me 16.08.2012, në lokalet e Infracosit.

Me datë 14.08.2012 deri me 16.08.2012 kemi mbajtur workshopin për llogaritjen e koston direkte dhe tarifave të Infrastrukturës për draft Ekspozeun e Rrjetit 2013.

Njëkohësisht u biseduan pikat lidhur me nenin 63 Llogaritja e koston direkte të infrastrukturës, pastaj neni 64 parimet e pagesës, neni 65 koston direkte të ndërlidhura me mirëmbajtjen e infrastrukturës, sipas Ligjit Nr.04/L-063.

Andaj, ne si ARH, përgjegjës për Departamentin e

Rregullimit të Tregut, vlen të theksojmë se janë bërë përmirësimet e domosdoshme në pikat ku është konstatuar se kishte gabime, të cilat u bënë bashkërisht me palët e interesit dhe në kuadër të infrastrukturës ligjore që posedojmë, në bazë të Ligjit 04/L-063, nenit 55 dhe 58 për Hekurudhat e Kosovës.

Pjesëmarrësit:

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave-ARH

*Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-
INFRAKOS*

Ekspert Ndërkombetar

OBJEKTIVAT E ARH-së PËR VITIN 2013

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, gjatë vitit 2013 do të punoj në arritjen e objektivave të mëposhtme:

- *Inspektimi i Infrastrukturës hekurudhore dhe vlerësimi i Sigurisë së tyre*
- *Monitorimi i plotësimit të kushteve për punimin e SMS brenda afatit prej 120 ditësh*
- *Inspektimi i Mjeteve lëvizëse hekurudhore, vlerësimi i Sigurisë së tyre*
- *Inspektimi i Sinjalizimeve në të gjitha linjat ekzistuese hekurudhore të cilat janë në përdorim etj*
- *Hartimin e bazës ligjore sekondare për Licencimin e Makinistëve*
- *Kompletimin e të gjitha procedurave për fillimin e Licencimit të Makinistëve*
- *Rishikimin e validitetit të Licencave të lëshuara TRAINKOS-it dhe INFRAKOS-it*
- *Kontrollimi dhe listimi i etniteteve përgjegjëse për mirëmbajtjen hekurudhore në territorin e Kosovës.*
- *Specifikimet Teknike për Interoperabilitet (Hartimi i Legjislacionit dhe teknikat e implementimit)*
- *Kontrollimet e kualifikimeve profesionale të personelit i cili kontribuon në operim dhe mirëmbajtjen e sistemit hekurudhor.*
- *Sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë*
- *Monitorimin e procesit të konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit 2014 sipas Ligjit të Hekurudhave*
- *Sigurimin se pagesat e vendosura nga INFRAKOS nuk janë diskriminuese, etj.*